

FJALA E DEPUTETIT ALBAN XHELILI

E MARTË 11 TETOR 2022

Përgëzoj përfaqësuesit që ndodhen në komision për prezantimin e tyre! Pyetjet i kam më shumë në rrafshin ekonomik sesa lidhur me termat teknikë të kësaj marrëveshje. Ashtu siç e përmendën edhe kolegët, kisha diçka lidhur me shtesën prej 30 milionë eurosh. Në parashikimin fillestar është kërkuar një fond prej 63,8 milionë euro, prandaj do të doja të dija nëse kërkesa për fondin shtesë prej 30 milionë eurosh ka të bëjë me një parashikim jo të saktë të nevojave apo ka ardhur si rezultat i ndonjë shtese në projekte? E para.

E dyta, kjo nuk është pyetje për ju, por gjithsesi doja ta bëja, lidhet me situatën e sotme ekonomike, nuk jam duke folur për situatën globale, por për situatën ekonomike të vendit tonë. Efikasiteti i kësaj shtese prej 30 milionë është më pozitiv sesa një shtesë për një hua çfarëdo 30-milionëshe në një sektor tjetër? Pra, dua të di se cili do të jetë efikasiteti i kësaj kredie, pavarësisht termave, sepse termat këtu janë favorizues? Faleminderit!